VENDIM
Nr. 4/2015

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË DETYRË NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 82/2014

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 82/2014, zgjatet për një periudhë 2-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015